



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

.Numri i lëndës: 2020:183440
Datë: 27.03.2024
Numri i dokumentit: 05512437

Ac.nr.1940/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin e përberë nga gjyqtarët Nora Bllaca-Dula, kryetare e kolegjit, Halide Reka dhe Arsim Hamzaj, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësve A.T dhe L.H të dy nga P....., të cilat i përfaqëson sipas autorizimit F.M, avokat nga Peja, kundër të paditurës Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë Prishtinë, rr. “Agim Ramadani”, pa.nr., të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore, për kompensimin e shujtës-shpenzimeve të ushqimit, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës, të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1688/2020, të datës 22.02.2022, në seancën e kolegjit, të mbajtur me datë 26.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET e pathemeltë ankesa e të paditurës Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë Prishtinë, rr. ”Agim Ramadani”, pa.nr, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1688/2020, të datës 22.02.2022, VËRTETOHET.

II. Mbetet e pashqyrtuar pika II e dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar, në pjesën refuzuese të kërkesëpadisë.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.1688/2020, të datës 22.02.2022, ka vendosur si vijon: “ I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditëseve A.T dhe L.H të dy nga P....., ashtu që DETYROHET e paditura Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë Prishtinë, rr.”Agim Ramadani”, pa.nr., që në emër të kompensimit të ushqimit gjatë punës (shujtave) paditëseve tua paguaj shumat dhe atë për paditësen A.T, për 577 ditë pune shumë prej 1,154.00 euro, për paditësin L.H, për 414 ditë pune shumë prej 828.00 euro, me kamatë ligjore prej 8 % në vit, e cila do të llogaritet nga data e ushtrimit të padisë me datë 23.12.2020, e të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm. II. REFUZOHET pjesërisht kërkesëpadia e paditëseve A.T dhe L.H të dy nga Peja përtej shumës së gjykuar, si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, dhe

atë për paditësen A.T për 49 ditë pune shumen prej 96 euro, për paditësin L.H për 51 ditë pune shumen prej 102 euro. III. DETYROHET e paditura Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë Prishtinë, rr. "Agim Ramadani", pa.nr., që paditëseve A.T dhe L.H të dy nga P....., t'ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në lartësi prej 580.00 Euro, e të gjitha këto t'i përmbushë në afat prej 7 dite, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi e nën kërcenim të përmbarimit të detyrueshëm".

Kundër këtij aktgjykimi, në afat ligjor, ka paraqitur ankesë e paditura, përmes të autorizuarit të saj, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, duke propozuar që Gjykata e Apelit e Kosovës të aprovojë ankesën dhe të ndryshojë aktgjykimin duke e refuzuar kërkesëpadinë e paditësve.

Përgjigje në ankesë nuk ka paraqitur paditësit.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa e të paditurës është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësit përmes të autorizuarit të tyre me datën 23.12.2020 kanë parashtruar padi kundër të paditurës, me objekt të kontestit, kompensimin e shpenzimeve të ushqimit. Me datën 15.12.2021 në seancën e shqyrtimit gjyqësor kanë bërë precizimin e kërkesëpadiisë, ku në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit për periudhën nga dt. 18.04.2017, e deri me dt. 30.11.2020, paditëseve tua paguaj shumat dhe atë për paditësen A. T, për 626 ditë pune shumën prej 1,252.00 euro, për paditësin L.H, për 465 ditë pune shumën prej 930.00 euro, me kamatë ligjore prej 8% nga data e ushtrimit të padisë e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kanosjen e përmbarimit, si dhe shpenzimet e procedurës.

Gjykata e shkallës së parë, duke vepruar sipas padisë së paditësve dhe precizimit të saj, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe administrimit të provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse, si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e ankimuar C.nr.1688/2020 të datës 22.02.2022, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësve, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të ankimuar gjykata e shkallës së parë ka theksuar se nga kontratat e punës me nunër protokollit 3/1048-1 të dt. 02.03.2016, për A.T, kontrata e punës me nunër protokollit 3/1048-17 të dt. 02.03.2016, për L.H, vërtetohet fakti se paditësit kanë lidhur kontrata pune në afat të pacaktuar me të paditurën këtu Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (MASH) rr. "Agim Ramadani", Prishtinë, për të kryer detyrat si në atë kontratë e cila nuk ishte kontestuese nga palët. Nga vërtetimet e lëshuara nga (Q.B.M.K.) ".....", në P....., vërtetohet fakti se paditësja A.T është në marrëdhënie pune në këtë qendër, dhe se nga dt. 18.04.2017 deri me dt. 30.11.2020, ka gjithsej 626 ditë pune, paditësi L.H është në marrëdhënie pune në këtë qendër, dhe se nga dt. 18.04.2017 deri me dt.30.11.2020, ka gjithsej 465 ditë pune. Nga kërkesat e paditësve për pagesën e shujtës të dt. 13.11.2020, vërtetohet fakti se paditësit i janë drejtuar palës se paditur e cila me datën 19.11.2020, ua ka refuzuar kërkesën paditëseve me arsyetimin se MASH dhe MF nuk kanë planifikuar buxhet shtesë për këtë çështje. Lidhur me faktin se e paditura me anë të përgjigjes në padi është thirrur në parashkrim dhe se me nenin 87 të Ligjit të

Punës gjykata e shkallës së parë ka gjetur se padia e paditësve është paraqitur me datë 23.12.2020, dhe nga dispozita e lartcekur rrjedh se kërkesa e paditësve është parashkruar për pjesën nga data 18.04.2017, deri me datë 23.12.2017, andaj gjykata e aprovoj pjesërisht kërkesë padinë e paditësve duke vendosur si në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar.

Lidhur me mënyrën e vendosjes vendimin e bazoi në nenin 35 paragrafi 7 të Kontratës Kolektive Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, për kamatën ka vendosur konform nenit 382 të LMD-së dhe vendimi për shpenzimet e procedurës kontestimore është bazuar në nenin 449, 452, 453.1 dhe 463 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k), n) dhe m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurës se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika n) e LPK-së (nga referati i ankesës kuptohet. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike, për faktin se nga kontratat e punës me nunër protokollit të dt. 02.03.2016, për A.T, kontrata e punës me nunër protokollit të dt. 02.03.2016, për L.H, vërtetohet fakti se paditësit kanë lidhur kontrata pune në afat të pacaktuar me të paditurën këtu Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (MASHT) rr. “Agim Ramadani”, Prishtinë, për të kryer detyrat si në atë kontratë e cila nuk ishte kontestuese nga palët. Nga vërtetimet e lëshuara nga (Q.B.M.K.) “.....”, në P....., vërtetohet fakti se paditësja A.T është në marrëdhënie pune në këtë qendër, dhe se nga dt. 18.04.2017 deri me dt. 30.11.2020, ka gjithsej 626 ditë pune, paditësi L.H është në marrëdhënie pune në këtë qendër, dhe se nga dt. 18.04.2017 deri me dt.30.11.2020, ka gjithsej 465 ditë pune. Gjykata e shkallës së parë, me rastin e vendosjes si në aktgjykimin e ankimuar, në mënyrë të drejtë dhe duke bazuar në ligj e ka zbatuar të drejtën materiale, duke u bazuar në nenin 35 par. 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë.

Gjykata e shkallës së parë, me rastin e vendosjes si në aktgjykimin e ankimuar, në mënyrë të drejtë e ka zbatuar të drejtën materiale për arsye se:

Me nenin 90 paragraf 1 të Ligjit të Punës 03/L-212 i datës 01.11.2010, përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet ndërmjet: a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe b) organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve”*. Me paragrafin 2 të këtij neni, përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në: a) nivel të vendit, b) nivel të degës dhe c) nivel të ndërmarrjes”*. Me paragrafin 3 të këtij neni, përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në Gjuhën Zyrtare të Republikës së Kosovës”*. Me

paragrafin 5 përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin për sipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive...”*.

Me nenin 35 paragrafin 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, përcaktohet se: *“Të punësuarve u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi, i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restorantit a kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim kompensimin për ushqim”*. Gjykata e shkallës së parë me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditëses, duke vendosur decidivisht si në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar, me të drejtë është bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, të lidhur dhe nënshkruar nga Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK-ut) dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e Republikës së Kosovës (MASHT), e cila kontratë ka qenë në fuqi me rastin e lindjes së të drejtës për parashtrim të kërkesës për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit për ditët e pranisë në punë, që nënkupton se kjo Kontratë shërben si akt nga i cili buron themelësia e kërkesëpadisë së paditësit.

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore, Gjykata e Apelit erdhi në përfundim se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vërtetuar se në këtë rast ekziston detyrimi juridiko - civil, ndaj paditësve për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit – shujtës gjatë ditëve të pranisë në punë, për arsye se me nenin 245 paragraf 1 të LMD-së, përcaktohet se: *“Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkoj përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbush atë me ndërjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”*.

Gjykata e shkallës së parë me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditëses, duke e obliguar të paditurën që në emër të kompensimit të shpenzimeve për ushqim, për paditësit A.T është në marrëdhënie pune në këtë qendër, dhe se nga dt. 18.04.2017 deri me dt. 30.11.2020, ka gjithsej 626 ditë pune, paditësi L.H është në marrëdhënie pune në këtë qendër, dhe se nga dt. 18.04.2017 deri me dt.30.11.2020, ka gjithsej 465 ditë pune, me të drejtë është bazuar në dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, të lidhur dhe nënshkruar nga Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK-ut) dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e Republikës së Kosovës (MASHT), e cila kontratë ka qenë në fuqi me rastin e parashtrimit të kërkesës për kompensimin shpenzimeve të ushqimit për ditët në punë, që rrjedhimisht nënkupton se kjo Kontratë shërben si akt nga i cili buron themelësia e kërkesëpadisë.

Në raport me pretendimin ankimor të të paditurës se e njëjta nuk ka mundur të planifikojë në skemën e saj buxhetore, linjë të veçantë për këtë lloj kompensimi, është i pabazuar, ngase një pretendim i tillë nuk e argumenton mos pagesën e pagave jubilarë dhe shujtës ditore, një e drejtë që i takon paditëses.

Vendimi mbi kamatën e përcaktuar është në përputhje me dispozitën e nenit 382 të LMD-së, ndërsa vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me dispozitën nga neni 452.1 të LPK-së, ndërsa veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese janë arsyetuar drejtë, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e LPK-së.

Gjykata e Apelit nuk e ka shqyrtuar aktgjykimin e atakuar në pikën II të dispozitivit në pjesën e refuzuar të kërkesëpadisë, ngase nuk kishte pretendime ankimore në këtë drejtim.

Gjykata e Apelit i shqyrtoi edhe të gjitha pretendimet tjera ankimore të palës ankuese, por të cilat nuk patën relevancë në vendosje ndryshe, prandaj vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 paragrafi 1 pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.1940/2022, me datë 26.03.2024

Kryetare e kolegjit,
Nora Bllaca-Dula, d.v